



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 74**

Datë: 03. 11. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Florian Dushi, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

1. **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
  - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 64, 65 dhe 66/2021.
2. **Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të zgjedhjeve lokale për Kryetarë të Komunave në Ferizaj, Shtime, Podujevë dhe Kllokot, të mbajtura më 17 tetor 2021.**
3. **Shpallja e Rezultateve Përfundimtare të zgjedhjeve lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më 17 tetor 2021.**
4. **Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**
  - Raport nga QNR-ja.

5. **Aktivitetet e ZRPPC-së:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve.

6. **Këshillat e KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i emërimit të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave, që do të mbahen më 14 nëntor 2021.

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

7. **Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik.**

8. **Të ndryshme.**

---

**1.Hyrje z. Kreshnik Radoniqi Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

**Kreshnik Radoniqi:** Sot, me rend të ditës kemi certifikimin e rezultateve përfundimtare për zgjedhjet lokale për kryetarë të komunave në komunën Ferizaj, Shtime, Podujevë për Kllokot por, na duhet me pritë edhe pak; kemi shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve lokale për kuvendet komunale të mbajtura me 17 tetor 2021 ndërsa, pjesa e dytë e mbledhjes do ta ketë shqyrtimin dhe miratimin e procesverbaleve 64, 65 dhe 66, aktivitetet e sekretariatit, aktivitetet e zyrës, këshillat e KQZ-së. A ka dikush diçka lidhur me agjendën ?

Tre anëtarët e komisionit që gjenden momentalisht zyrtarisht jashtë shtetit Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj dhe Ilir Gashi, janë duke na ndjekur online., gjatë mbledhjes janë prezentë edhe ata. Për momentin, Rifat Krasniq nuk është prezent deri sa të na bashkangjitet. A ka dikush diçka lidhur me agjendën ? Nëse jo, kush është për ?

Me 10 vota për miratohet agjenda e takimit.

## **2.Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të zgjedhjeve lokale për Kryetarë të Komunave në Ferizaj, Shtime, Podujevë dhe Kllokot, të mbajtura më 17 tetor 2021:**

**Kreshnik Radoniqi:** Vazhdojmë... Në mbledhjen e kaluar, KQZ ka certifikuar rezultatet përfundimtare për kryetarë të 34 komunave ndërsa për 4 komuna tjera, është Ferizaji, Shtimja, Podujeva dhe Kllokoti kishte ankesa, dhe se shqyrtimi i tyre nuk kishte përfunduar nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme. KQZ, tani mund të bëjë certifikimin e rezultateve përfundimtare për zgjedhjet për kryetar të këtyre tri komunave: Ferizaj, Shtime dhe Podujevë ndërsa për komunën e Kllokotit, do të presim derisa të kemi konfirmimin zyrtar se a kanë përfunduar shqyrtimin e ankesës në Gjykatën Supreme; do të thotë kemi certifikimin e rezultateve për kryetar komune në Ferizaj. Dhe kryetar komune në Ferizaj, është zgjedhur Agim Aliu nga PDK.

Kush është për certifikimin e z. Aliu ?

Me vota unanime certifikohet rezultati për kryetar komune në Ferizaj me fitues Agim Aliu.

Për kryetar komune në Shtime në raundin e dytë, do të shkojnë kandidatët Qemaj Aliu nga LVV, dhe Naim Ismajli nga PDK. Kush është për...?

**Arianit Elshani:** Pra, po e shoh këtë vendimin propozimin që është bërë lidhur me votat e kandidatit të PDK-së, Naim Ismajli në uebfaqe të KQZ-së numri total i votave është 5865, ndërsa në vendim 5824 vota por, kjo ka qenë një kërkesë që është bërë ankesë edhe në PZAP lidhur me këtë numërim të votave pra, procesin e rinumërimit që ka ndodhur në QNR. Prandaj, ky vendim duhet të ndryshohet dhe duhet të përditësohet ashtu siç janë edhe formularët e rezultateve të kandidatëve të komunës së Shtimes, pra kjo ka qenë një çështje pse është vonuar dhe deri sot. Pra, është “5865 vota” dhe nuk është e vetmja komunë ku ka ndodhur një lëshim i tillë për të cilën kam raportuar edhe në sekretariat lidhur me votat e PDK-së; Kandidatit të PDK në komunën e Vushtrrisë të cilit i janë bartur kandidatit të LDK-së prandaj, para se të vijjnë këto rekomandime këto vendime është mirë që sekretariati të koordinohet mirë edhe me QNR-në, por edhe me përgjegjësit të cilët publikojnë rezultatet në uebfaqe...

**Alim Rama:** Ky lëshim teknik, nuk ndikon fare në rezultat, kjo komunë shkon në rinumërim, as përqindja nuk ndërron, sigurisht që sekretariati duhet me pas kujdes në publikimin e të dhënave...

**Florian Dushi:** E para, mendoj që duhet të jemi të kujdesshëm kur flasim dhe të mos i përgjithësojmë gjërat sepse, nëse ne si anëtarë të KQZ-së themi se nuk është e vetmja komunë, sepse ka edhe shumë komuna tjera atëherë kjo më frikëson mua. Nuk dëshiroj që në asnjë komunë madje, asnjë votë e vetme pavarësisht faktit që kjo komunë komuna e Shtimes dhe ndonjë komunë tjetër do të shkojnë në raundin

e dytë, jemi këtu të thirrur për të verifikuar dhe për të shpallur rezultate 100 % të sakta, pavarësisht raudit të dytë. Jemi këtu për të shpallur rezultate të zgjedhjeve në të cilat kanë votuar secili qytetar, dhe jemi këtu për të shpallur secilën votë të qytetarëve tonë në kuadër të rezultatit përmbledhës përfundimtar të secilit kandidat prandaj, duke kërkuar t'i ikim përgjithësisht sepse, kështu e lëndojmë idenë dhe konkludimin e përgjithshëm që ekziston: se, zgjedhjet megjithatë kanë shkuar mirë por në anën tjetër, edhe kërkoj që të verifikohet dhe të kemi rezultate 100 % të sakta...

**Arianit Elshani:** Unë, po i referohem një vendimi të PZAP-së, e ku PZAP ka hedhur poshtë kërkesën e kandidatit të PDK-së ku në këtë rast, shefit të shtabit që ka qenë si kërkesë nga ai me arsyetimin se KQZ ka bërë përmirësime dhe këtë përmirësim unë nuk e pashë në vendim. Kjo, është arsyeja që e ngrita këtë çështje, pra ne kemi një vendim të PZAP-së e cila thotë që KQZ, ka bërë përmirësime kurse në rekomandimin që vie sot në vendim, nuk evidentohet ky përmirësim...

**Florian Dushi:** Po e kuptoj plotësisht kolegun, madje po e mirëkuptoj prapë: jam kundër procesimit, duhet saktësisht t'i themi komunat sikur që e tha 1, 2... por, megjithatë në krahasim me 38 komuna nuk janë shumë komuna dhe lëshime të tilla teknike mendoj që janë njerëzore. Duhet të kemi edhe për to mirëkuptim me kusht që ato të identifikohen dhe të korrigjohen; tash unë dua ta dëgjoj versionin e sekretariatit pse s'ka ndodhë ky korrigjim, nëse PZAP e ka hedhur poshtë sepse është deklaruar se KQZ e ka bërë përmirësimin. Unë besoj që PZAP-i ka marrë një përgjegje nga KQZ-ja që e kemi bërë përmirësimin dhe nëse PZAP-it i kanë thënë që e kemi bërë këtë korrigjim, pse nuk është bërë në materialin që na është servuar përpara ? Prandaj, unë plotësisht po pajtohem dhe jam shumë i sigurt që kolegu ka qenë shumë i vëmendshëm në raport me këto rezultate të komunës së Shtimes sikurse, besoj edhe kolegët tjerë që janë në rauditin e dytë. Shtimja, është tejet me rëndësi për ta por, po më intereson versioni i sekretariatit pse s'ka ndodhur ky korrigjim...?

**Besnik Buzhala:** Po, kryesues në ueb faqe është përmirësuar. Me gjasë, është lëshim teknik. Në faqen e KQZ-së, është korrigjuar "5865" por puna është se ky është rezultati i saktë, mirëpo gjatë përpilimit të vendimit ka ndodhur gabim: 44.54 % me vota i bie 5865, ndërsa në vendim këtu është: "5824".

**Alim Rama:** Në qoftë se këto të dhënat nuk janë të sakta, atëherë në nuk mundemi me shkue ma tutje ! Në ueb faqe ? Tash, nuk jam i bindur në cilën ueb faqe: një formular një FPR që ka mundur të ngjajë lëshim teknik dhe unë e kuptoj edhe pse nuk është dashur të ndodhë kjo, por ne nuk mundemi me vazhdue më tutje. Ne, ta bëjmë tabulimin tjetër përsëri. Ne e kemi një raport nga QNR q thotë: Qemajl Aliu ka 5964

vota ose 45.29%, Naim Ismajli 5824 vota ose 44.23 %, Bedri Zeqiri 1361 vota... Këto janë prej sistemit, këto janë prej QNR-së...

**Kreshnik Radoniqi**: Mirë, unë po e hedh në votim me përmirësimin e bërë. Kush është për certifikimin e rezultatit për kryetar komune në Shtime ku kandidatë në raundin e dytë janë Qemajl Aliu dhe Naim Ismajli ?

Me vota unanime, certifikohet rezultati për kryetar komune në Shtime

**Kreshnik Radoniqi**: Për kryetar komune në Podujevë në raundin e dytë shkojnë kandidatët Ekrem Hyseni nga LDK me 44.20 % dhe Shpejtim Bulliqi nga LVV me 44.16 %. A ka dikush diçka të shtojë lidhur me këtë ? Atëherë, kush është për certifikimin e këtij rezultati ?

Me vota unanime certifikohet rezultati për komunën e Podujevës

**Kreshnik Radoniqi**: Për komunën e Kllokotit, do të presim ose gjatë ditës ose në mbledhjen e radhës.

### **3. Shpallja e Rezultateve Përfundimtare të zgjedhjeve lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më 17 tetor 2021:**

Vazhdojmë me pikën e dytë: shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale për 38 kuvendet komunale të mbajtura me 17 tetor 2021, unë nuk do ti lexoj emrat e të gjithë kandidatëve të zgjedhur sepse janë 1002 në të gjithë Kosovën por do të prezantoj vetëm numrin e ulëseve që secili subjekt ka fituar në secilën komunë, rezultatet e detajuara për të gjithë kandidatët rreth 5200 i gjeni në ueb faqen e KQZ-së, shpallja e këtyre rezultateve bëhet pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime në QNR dhe pas konfirmimit nga PAZP dhe Gjykata Supreme se nuk ka ndonjë çështje në shqyrtim e sipër ...

Me vota unanime miratohen rezultatet për kuvendet komunale veç e veç për secilën komunë përveç në komunën e Ranillugut miratohet rezultati me 9 vota për dhe një kundër

**Kreshnik Radoniqi**: Këto, janë rezultate për asamble komunale i njoftoje të gjitha subjektet politike që duke filluar nga tani ora 15:00.

**Florian Dushi**: Megjithatë, edhe prej leximit që kemi bere së shpalljes së rezultateve në rundin e pare vendimet e nënshkuara neve na kane ardhur dukshëm më vonë mos të them 1 ore 1 ore e gjysme më vonë, prandaj po them që të jete ora fikse tani por të jetë kur vendimet e nënshkuara nga ana juaj do të publikohen.

**Kreshnik Radoniqi**: Atëherë njoftohen të gjitha subjektet politike se duke filluar nga ora 16:00, sot fillon afati i ankesave brenda 24h ne panelin për ankesa dhe parashtrësia. Më qartë, deri nesër në ora 16:00 është afati i hapur...

**Kreshnik Radoniqi**: E kemi shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve 64,65,66 a ka dikush diçka ?

Atëherë kush është për miratimin e tyre, më 7 vota për 1 abstenim miratohen procesverbalet.

#### **4.Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së**

Raport nga QNR-ja:

**Besnik Buzhala**: Faleminderit kryesues, para jush e keni raportin e aktiviteteve të sekretariatit të KQZ-së sa i përket shtypjes së listave përfundimtare të votuesve. Ky aktivitet, u mbyll dje më datën 2 nëntor 2021 ndërsa, është duke vazhduar procesi i shtypjes kontrollimit dhe paketimit për cilin proces po mendoj që do të përmbyllet më datën 5 nëntor 2021.

Ndërsa, sa i përket regjistrimit të votuesve me nevoja të veçanta, është fjala për kategorinë e dytë të votuesve në institucione. Ne, kemi dërguar një shkresë tek shërbimi korrektus i Kosovës ku, kemi kërkuar që më se largu deri më 5 nëntor të pranojnë të dhënat e votuesve që do të jene në qendrat e paraburgimit. Ndërsa, sa i përket raportit të QNR-së ka përfunduar procesi i rinumërimit të 291 vendvotimeve ku ky proces ka filluar më datën 30 tetor 2021 dhe ka përfunduar më datën 2 nëntor 2021 rreth orës 22.30, pra pas përfundimit të këtij procesi janë; Formularët e këtyre rezultateve në bazën e të dhënave ku do të përfshihen në rezultatet përfundimtarë d.m.th, është fjala për zgjedhje për kuvende komunale.

**Arianit Elshani** : Faleminderit kryesues, kame një pike që nuk është raportuar lidhur më publikimin e gjitha formularëve të rezultateve unë edhe sot por edhe gjate ditëve të kaluara kam marr kërkesa nga përfaqësuesit në KKZ-ë të cilët kane raportuar që disa formular të rezultateve nuk janë publikuar në ueb faqe të KQZ-së, duke qene se nga ora 16 fillon edhe afati i ankesave në PZAP-ë për gjithë kandidatet dhe subjektet mendoj që duhet urgjentisht të shikohet të evidentohet secili formular: a, është i publikuar apo nuk është i publikuar në ueb faqe. Pra, edhe sa i përket votave me kusht, dhe sa i përket votave më postë edhe ato të rinumëruara dhe ato të cilat janë numëruara gjatë ditës së votimit, unë i kame dy kërkesa që besoj që do të i trajtoni: është për Hanin e Elezit për votimin më nevoja te veçanta, dhe formularët e

rezultateve mungojnë sipas raportimit dhe votat me kushte nuk janë të publikuara në Malishevë, pra edhe kjo për komunën e Malishevës. Këto dy kërkesa, shikoni nëse janë të publikuara në tërësi dhe tjetra, edhe ajo kërkesë që e patëm në mbledhjen jo formale të mbajtur poshtë lidhur më raportin e 10%. Pra, të përgatitet një raport i tillë për nesër, të mbajmë një mbledhje të KOZ-it dhe të shohim të gjeturat e atij raporti.

**Alim Rama:** Unë, e pash një mungesë në raport mungon progresi i shtypjes së fletëvotimeve duke marr parasysh ato kanë filluar të dielën ku ndodhet procesi në këtë aspekt edhe isha ndërlidhje më kërkesën që ka bërë z. Elshani lidhur më raportin e ..... duhet të kemi të qarta në baze të cilit rekomandim cilat janë të gjeturat e rinumërimit nëse auditimi ka qenë baze një mostre rastësishme nga 10% ku dëshmoje 35% a sa kanë qenë problematike të cilët janë rinumëruar tash se paku kanë qenë 3 lloje të rekomandimeve një ka qenë gabimi në bartje dhe lista ka qenë ato gabime të vogla në bartje sa ka ndikuar, neve na mungon ajo e gjetur sa ka qenë realisht rezultati përfundimtar.

**Kreshnik Radoniqi:** Dikush tjetër diçka...? Besnik...?

**Besnik Buzhala:** Sa i përket Hanit të Elezit dhe Malishevës që mungojnë formularët e rezultateve për votuesit me nevoja të veçanta dhe votuesit më kusht, unë e kam dërguar një email mr herët tek stafi përgjegjës i sekretariatit me na dërguar këtë raport në mënyrë që nesër, m'u shqyrtuar në KOZ një raport i detajuar...

**Florian Dushi :** Të gjitha këto janë tema që kanë një afat ose mund të presin edhe pak ajo që nuk pret fare është siguron ju lutem që gjitha rezultatet që sot janë shpallur të i kemi edhe formularët e përputhjeve së rezultateve le të kenë mundësi kandidatet që të i shohin të i analizojnë dhe të vlerësojnë më tutje ne qofte se kanë nevojë më bo ankese diku ose jo. Është kohe shumë e shkurte ku siguron para orës 16:00 ku ne kemi vendosur si afate të fundit këtë këto të dhëna të jone të gjitha në ueb faqe e KQZ-së.

**Besnik Buzhala :** Një përgjigje për z. Rama sa i përket procesit për shtypje të fletëvotimeve përfundon të enjten.

**Alim Rama:** Një pyetje lidhur më regjistrimin e votuesve më nevoja të veçanta këtu e ke paraqitur gjendjen për kategorinë e dyte votuese në institucione çka ndodhe për ata që janë të ngujuar në shtëpi, a kanë nevojë me u ri regjistruar apo përdoret regjistri nga rundi i parë...? .

**Besnik Buzhala:** Kategoria e pare e votuesve më nevoja të veçanta ata të cilët për shkak pa aftësisë fizike apo shëndetësorë nuk mundën më dal në ditën e zgjedhjeve në vendvotimin e caktuar për ta vlen regjistrimi i njëjte që është siç është bere në rundin e pare. Ndërsa, për kategorinë e dyte ata që janë të hospatiluzar në ditën e zgjedhjeve të dhënat e tyre do të merren më së largu 10 Nëntor, ideja është që me gene sa më afër ditës së zgjedhjeve.

## 5. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve:

**Yll Buleshkaj:** Kemi pranim konfirmim për vëzhgues e po ashtu, edhe më kërkesa për akreditim të vëzhguesve të riye. Para jush e kemi paraqitur rekomandimin për akreditim të 4 vëzhgueseve të OJQ-së vendore. I kanë plotësuar kushtet..

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ? Atëherë, më 8 vota për **akreditohen këta vëzhgues vendorë.**

**Buleshkaj:** Në radhë është aplikimi që kemi shqyrtuar e medias “Vushtrria Online” me 2 vëzhgues.

**Kreshnik Radoniqi: Akreditohen me 8 vota për.**

**Yll Buleshkaj:** Po ashtu, kemi pranuar një aplikacione nga ambasada e Zvicrës në Prishtine ose, të cilët kane aplikuar për akreditimin e 3 vëzhgueseve.

**Kreshnik Radoniqi:** Akreditohen, me 8 vota për.

**Yll Buleshkaj:** Jemi në proces te pranimeve të konfirmimeve, kemi pranuar konfirmime për vëzhgues nga LDK, AAK, kemi pranuar nga disa OJQ edhe presim tani nga gjitha partitë politike që të konfirmojnë mënyre që të fillojmë në kohe edhe distriktive të ri, e po ashtu të kryem procesin sa më herët që është e mundshme. Afati është deri më datën 8.

**Arianit Elshani:** Kam edhe një çështje që lidhet më zyrën për regjistrimin e partive politike lidhur më financat e subjekteve politike pra ne tani më kemi marr një vendim ku mjetet e grupeve parlamentare i



kemi bartur për menaxhim për administrim tek subjektet politike mirëpo janë edhe në kuadër të ati fondit që ka qene e menaxhuar nga KQZ-ë deri më tani ka mbetur para në kontot e KQZ-së prandaj çka do të behet më ato mjete mendoj që duhet të transferohen tek subjektet politike ato që nuk janë shpenzuar deri më tani gjate këtyre muajve që kane marr subjektet politike prandaj nëse mund të na jepni një sqarim së çka keni menduar të bëni më ato mjete që kane tepruar për gjate këtyre muajve.

**Yll Buleshkaj**: Faleminderit shumë për pyetjen, është po besoj relevante për të gjithë edhe për juve edhe për neve si administrate jemi në proces të paktën administrata jone, dhe është ne pastrimin të gjitha faturave që kane ardhur dhe më gjase javën e ardhshme. Do të bijimë rekomandimin para jush të bëni transferimin fondet e mbetura të patritë politikë sepse, ketë jave divizioni për financa dhe buxhet do të i njoftojë të gjitha grupet parlamentare që është afati i fundit për të sjell ndonjë fature për shpenzimet që kanë ndodhur para muajt tetor.

## **6. Këshillat e KQZ-së**

### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i emërimit të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave, që do të mbahen më 14 nëntor 2021:

**Arianit Elshani**: KOZ-ë ka shqyrtuar rekomandimin e sekretariatit për emërimin e këshillave të vendvotimit për rundin e dyte për zgjedhjet për kryetare të komunave. Besoj që para vetes secili e keni ketë rekomandim të sekretariatit lidhur më formulën e ndarjes dhe përbërjen e të gjitha subjekteve politike duke e respektuar ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe rregullën zgjedhore që përcakton ndarjen e këshillave të vendvotimit për rundin e dyte të zgjedhjeve ne kemi përfaqësuar të gjitha ato subjekte të cilat nuk kane qene të përfaqësuar në këshillat e vendvotimit duke e pasur në secilin vendvotime nga një komisioner kësaj radhe me qene së është obligime i rregullës zgjedhore është ndare për secilin kandidat të pavarur apo subjekt i cili ka qene i pa përfaqësuar në çdo vendvotim. Tani i është mundësuar që të përfaqësohet në ato këshilla të vendvotimit dhe se janë tre çështje të cilat i kemi trajtuar veçmas ka një avantazh të kryesuesve nga një ose dy kryesues për subjektet të cilat janë në gare mes vete në komunitat përkatëse pra tjetra edhe at ndarjen që kemi rene dakord edhe gjate mbledhjeve të kaluara që dhënësi i fletëvotimeve dhe zyrtari identifikues duhet të ju takojnë subjekteve politikë që janë ne gare por që nuk ju takon kryesuesi në at vendvotim pra të kenë njëri nga këto dy funksione. Dhe një çështje tjetër të cilën jemi duke e pritur nga sekretariati është raporti i pare i 10% te hetimit pastaj raportin e

vendotimeve që kanë shkuar në rinumërim më qellim që të identifikojmë kryesuesit dhe komisionerët e të gjitha subjekteve politike që kanë qene në ato vendotime ku është evidentuar që ka pasur pa rregullsi më ç 'raste i kanë dërguar ato kuti në rinumërim pra të kemi një liste të atyre, një kategorizime të atyre që kanë dërguar në rinumërim ato kuti dhe në baze të asaj KOZ-ë do të rekomandoj në KQZ-ë largimin e komisionerve dhe kryesuesve në çoftë se parape janë nominuar nga subjektet politikë për rundin e dytë të zgjedhjeve.

Prandaj, si kryesues i KOZ-ë rekomandoj që ky rekomandim i sekretariatit të aprovohet janë total 10.336 komisioner rezerve dhe ata të rregullt të cilët do të janë të përfshire gjate rundit të dyte të zgjedhjeve.

**Kreshnik Radoniqi** : A ka dikush diçka lidhur më këtë rekomandim? Nëse jo, e hedh në votim. Kush është për? Atëherë, me 8 vota miratohet rekomandimi për emërimin e këshillave të vendotimeve.

#### **Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës:

**Florian Dushi**: Këshilli për çështje ligjore ka mbajtur takimin sot më një pike të vetme të rendit të ditës që ndërlidhet më kërkesën e zonjës Presidente, lidhur më zëvendësimin e deputetit deri më tani të z. Bedri Hamza i cili është certifikuar si kryetare i komunës së Mitrovicës. Sekretariati ka berë analizimin dhe rekomandimin e nevojshëm sipas të cilit deputeti i deritanishëm z. Bedri Hamza zëvendësohet nga kandidati i radhës i PDK-së sipas numrit të votave z. Rashit Qalaj. Pra sipas kësaj KQZ-ë duhet të aprovoje këtë njoftime i cili do të i dërgohet Presidentes së Kosovës për të bere zëvendësimin sipas ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për? Më 8 vota për aprovohet rekomandimi ku Rashit Qalaj zëvendëson Bedri hamzajn.

Pika e radhës është këshilli mbikëqyrës për informime publik, Gordana ka qene në vend të Fazliut si kryesuese, urdhëro Gordana ?

#### **7. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik**

**Gordana Llaban:** Këshilli mbikqyrës, e ka mbajtur takimin dhe janë shqyrtuar të gjitha produktet e informimit për votim në raundin e dytë: videot televizive dhe radio spotet, publikimet e rrjeteve sociale, dhe dizajnët, mediaplanet e ndryshme etj. Janë disa media dhe radio, si dhe rrjete sociale. Znj. Llaban, raportoi me të dhëna për këto media se ku janë bërë publikimet, si dhe për mediaplanin se ku do të bëhen publikimet për raundin e dytë...

### **Të ndryshme!**

**Gordana Llaban:** Pyeti rretj gjendjes së kryesuesit të KKZ-së për Dragash pas fatkeqësisë së pësuar të komunikacionit, dhe ajo propozoi që i njëjti të përkrahet jo vetëm moralisht, por edhe materialisht... Ajo, ftoi që të gjithë bashkarisht, KQZ-në dhe SKQZ-në që t'i dalin në ndihmë kolegut...

Kryetari, z. Radoniqi premtoi se pesonalisht, do të merret me rastin...